Pjesa e mbetur prej 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) e kapitalit të nënshkruar do të paguhet nga aksionarët në përputhje me afatet dhe mënyrat e përcaktuara nga legjislacionin përkatës, por që do të vendosen nga organi administrativ.

NENI 5) Palët e paraqitura konstatojnë se shoqëria do të administrohet nga një Administrator i vetëm, i cili është caktuar z. Fiorini Roberto, deri në revokimin, shkarkimin, dorëheqjen apo vdekjen e tij. Zotëria e pranon këtë detyrë dhe deklaron se nuk është i prekur nga asnjë prej pengesave të parashtruara në Nenin 2382 të Kodit Civil italian.

NENI 6) Viti financiar fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të vitit kalendarik. Viti parë financiar përfundon më 31 dhjetor 2005.

NENI 7) Kohëzgjatja e shoqërisë është e caktuar deri më 31 dhjetor 2050 dhe mund të zgjatet ose edhe të shpërndalet përpara kësaj date me vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me ligjin.

NENI 8) Shoqëria konsiderohet e themeluar në përmbushje të plotë dhe zbatim të saktë të rregullave në lidhje me funksionimin e saj të parashikuara në statut, i cili është përbërë nga nr. 32 (tridhjetë e dy) nene dhe miratohet nga palët e paraqitura të firmosura prej tyre së bashku me mua, Noterin. Ky dokument i bashkëlidhet këtij akti themelimi si shtojca "B", duke qenë pjesë përbërëse e pandashme e tij.

NENI 9) Për çdo gjë që nuk parashikohet shprehimisht në këtë akt themelimi dhe në statutin e bashkëlidhur, zbatohen rregullat për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, të parashtruara në Kodin Civil italian dhe në ligjet e veçanta.

NENI 10) Palët e paraqitura autorizojnë administratorin e vetëm, siç është emërtuar më sipër, që të bëjë pjesë të këtij akti themelimi dhe në statutit të bashkëlidhur të gjitha ndryshimet, shtesat, fshirjet dhe saktësimet që mund të kërkohen nga autoritetet kompetente dhe në të njëjtën kohë të të kujdeset për të gjitha praktikatat dhe formalitetet e nevojshme për përmirësimin ligjor dhe depozitimin e këtij akti, duke qenë të miratuara të gjitha veprimet tij që tani e tutje.

NENI 11) Z. Forini Roberto delegohet gjithashtu që të tërheqë në kohën e duhur shumën prej 25% (njëzet e pesë për qind) të kapitalit të nënshkruar në Banca Monte dei Paschi di Siena S.P.A., Dega Bastia Umbra, me të drejtën e lëshimit të faturës dhe shkarkimit, duke e përjashtuar institucionin e sipërpërmendur financiar dhe zyrtarët e tij nga çdo pakujdesi dhe përgjegjësi në këtë drejtim.

NENI 12) Shpenzimet e këtij akti dhe ato të mëpasshme mbeten përgjegjësi e shoqërisë, duke pasur një shumë të përgjithshme e të përafërt, të përcaktuar nga palët prej 1500 euro.

NENI 13) Në bazë të ligjit 151, më 19 maj 1975, z. Calzoni Fabio deklaron se i ka dhënë shoqërisë një send në pronësi vetjake.

NENI 14) Z. Fiorini Roberto përjashtohet shprehimisht nga respektimi i ndalimit të konkurrencës në zbatim të nenit 2390 të Kodit Civil italian. Palët shprehimisht dhe unanimisht më përjashtojnë në përputhje me leximin e shtojcave, duke deklaruar se kanë njohuri të sakta në lidhje me këtë çështje.

Me kërkesë të të lartpërmendurve, unë, Noteri, e marr këtë akt të lexuar prej meje palëve të paraqitura, të cilat pas kërkesës sime deklarojnë se e miratojnë atë. Dokument pjesërisht i daktilogruar në përputhje me ligjin nga një person të cilit i besoj dhe pjesërisht i shkruar në dorën time në katër kopje, secila me pesëmbëdhjetë faqe dhe një faqe të gjashtëmbëdhjetë të pjesshme.

Nënshkruar nga:

CALZONI FABIO
FALCHETTI NATALINO
FALCHETTI ANDREA
FORINI ROBERTO
FANINI ROBERTO
NOTERI PETTINACCI PAOLO MARIA

MONTE DEI PASCHI DI SIENA
BANKË E THEMELUAR NË VITIN 1472
GRUPI MPS



BANKA MONTE DEI PASCHI DI SIENA
Shoqëri aksionare, Selia ligjore në Sienë, Sheshi Salimbeni 3
Kapitali 1.935.272.632,00 Euro, Rezervat 4.052.760.943,32 Euro
Kodi tatimor, Numri i TVSH dhe Nr. i regjistrimit në Regjistrin e Ndërmarrjeve të Sienës:
00884060526 -www.mps.it
Grupi Bankar Monte dei Paschi di Siena
Kodi i Bankës 1030.6 – Kodi i Grupit 1030.6
Pjesëmarrës i Fondit Ndërbankar për Ruajtjen e Depozitave

Shtojca fj al
!!!, l S; l, 8, j:: f. filil:: i reportorit.

, më 05/05/2005

SHOQËRITË THEMELUESE
Versamento del 25% o del totale del capitale

SEKURITALIA S.R.L.
(emërtimi ose objekti i shoqërisë që është themeluar)
SHITJA E MATERIALEVE KUNDËR ZJARRIT DHE KUNDËR INCIDENTEVE NË PUNË,
MIRËMBAJTJES SË IMPIANTEVE, OFRIMI I SHËRBIMEVE TË LIDHURA ME SIGURINË NË
VENDIN E PUNËS – DEKRETI LEGJISLATIV NR. 626
(objekti i shoqërisë)

SHESHI MONCADA 2 BASTIA UMBRA
(selia e shoqërisë) 10,000
(kapitali i paraqitur në euro)

Z. FANINI ROBERTO, lindur në FOLIGNO, më 18/06/1969, me banim në BASTIA UMBRA,
Rruga DEL CONSERVIFICIO Nr. 59, me kod tatimor FNNRRT69H18D653Z, me dokument
identifikues leja e drejtimit të mjetit nr. PG5207220M, lëshuar më 23/01/1989 nga
Motorizimi Civil në cilësinë e Administratorit derdhi sot në këtë arkë për llogari të
ortakut/ortakëve, nënshkruesit/nënshkruesve të kësaj Shoqërie në përputhje dhe për
shkak të Neneve:

- 2342 të Kodit Civil – për themelimin e Shoqërive Aksionare me një aksionar të vetëm.
- 2454 të E.E. – për themelimin e Shoqërive Aksionare me përgjegjësi të kufizuar IRI 2464 C.C. – për themelimin e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar dhe me Përgjegjësi të Kufizuar me një ortak të vetëm



Shuma e treguar më poshtë përfaqëson:

IRI 25% e kapitalit të lartpërmendur

- % e kapitalit të lartpërmendur (masa duhet të jetë më e madhe sesa 25%)
- TOTALI i kapitalit të lartpërmendur (i detyrueshëm për Shoqërinë Aksionare dhe Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me një ortak të vetëm).

ORTAKËT NËNSHKRUES		
Emri dhe mbiemri Objeti apo Emërtimi i shoqërisë	Të dhënat e plota personale (vendi dhe data e lindjes, kodi tatimor dhe adresa e banimit)	Kuotat e pjesëmarrjes në çastin e derdhjes së fondeve
FALCO SERVIZI SNC	LOKALITETI SAN MARCO- MONTEFALCO Kodi Tatimor 02280830544	1.250,00
CALZONI FABIO	FOLIGNO 10.06.1974 CLZFBA74H10D653 RRUGA FIRENZE 53 BASTIA UMBRA	1.250,00
Shuma totale e dedhur në Eujro		2.500,00

(euro dymijë e pesëqind)

..

DERDHËSI

(Nënshkrimi)

EDHE PËR NJOHJEN ME

NORMAT E POSHTË SHËNUARA

ARKËTARI

(Nënshkrimi)

BANKA MONTI DEI PASCHI DI SIENA SHA

Filiali i BASTIA UMBRA

NJOFTIM

- Për ata që kanë bërë pagesën në Bankë, kjo faturë nuk do të ketë më efekt pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive, sepse, sipas ligjit, shuma e paguar duhet t'i kthehet shoqërisë për llogari të "administratorëve" ose kujtdo që është i lidhur me ta.
- Nëse shoqëria nuk regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive brenda 90 ditëve nga koha e treguar në nenin 2331 ose në nenin 223/4, dispozitat kalimtare dhe për hyrjen në fuqi të Kodit Civil, shuma e paguar duhet t'u kthehet nënshkruesve.
- Në të dyja rastet e përmendura më sipër, kjo faturë duhet t'i kthehet Bankës pas arkëtimit të shumës.

NORMAT QË RREGULLOJNË DEPOZITAT E 25% (OSE TË TOTALIT) TË KAPITALIT TË
SHOQËRISË THEMELUESE

I nënshkruari njeh dhe pranon se:

Neni 1. Për qëllime të kthimit të shumave të depozituara - e cila bëhet duke kredituar një llogari në emër të personave që kanë të drejtë ose duke lëshuar një çek të patransferueshëm në arkë sipas porosisë së të njëjtit - shoqëria e kreditit në çdo rast duhet t'i paraqitet faturën e pagesës ose kopjen autentike të aktit të themelimit të shoqërisë, ku këtij akti i bashkëlidhet edhe dëftesa origjinale.

Në rast se nuk janë në gjendje të paraqesin faturën, ata që kanë të drejtën e kthimit të depozitës duhet të nënshkruajnë një deklaratë e cila, duke treguar arsyet e mosparaqitjes (shkatërrim, humbje ose vjedhje), dëmshpërblen kompaninë e kreditit nga çdo dëm që mund të rrjedhë për çfarëdo arsye nga kthimi i depozitës pa paraqitjen e faturës.

Neni 2 - Nëse shoqëria është themeluar, certifikata e regjistrimit në Regjistrin e Biznesit duhet të paraqitet edhe në Zyrën e Regjistrimit të Bizneseve në juridiksionin e së cilës ndodhet selia e shoqërisë - një certifikatë e lëshuar kohët e fundit dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj më parë - certifikatë e cila vërteton se shoqëria është regjistruar dhe zotëron plotësisht dhe lirisht të drejtat e saj; kjo certifikatë duhet të përmbajë edhe të dhënat e plota personale të administratorëve në detyrë që përfaqësojnë shoqërinë, duke specifikuar nëse janë të nënshkruar bashkërisht apo veçmas.

Neni 3 - Në rast të dështimit të themelimit të shoqërisë, duhet të paraqitet edhe një vërtetim nga Regjistri kompetent i shoqërive - një certifikatë e lëshuar kohët e fundit dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj më parë - që vërteton se asnjë akt në lidhje me shoqërinë që duhej themeluar nuk është regjistruar ose depozituar.

Neni 4 - Në rast të themelimit të rregullt të shoqërisë, subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e shumave janë administratorët në detyrë që përfaqësojnë vetë shoqërinë. Në rast të mosthemelimit të shoqërisë, subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e shumave janë nënshkruerit, 90 ditë pas çastit të përcaktuar në nenin 2331 ose në nenin 223/4, dispozitat kalimtare dhe për hyrjen në fuqi të Kodit Civil.

Neni 5 - Në rast të mosthemelimit të shoqërisë, rimbursimi u bëhet palëve që kanë të drejtë bashkërisht dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme kjo shoqëri krediti rezervon të drejtën ta lejojë atë proporcionalisht për nënshkruerit individualë. Është gjithashtu e drejta e kësaj shoqërie të kthejë shumat përpara skadimit të afateve të ligjit, me përjashtim të rastit të rimbursimit në përputhje me kuotat dhe në çdo rast me paraqitjen e tij, përveç dokumentacionit të përmendur në nenin 3 më sipër të një deklaratë të të gjithë nënshkruerëve, me të cilët deklarohen të heqin dorë nga themelimi i shoqërisë.

STUDIO E NOTERIT

Dott. PAOLO MARIA PITTINACCI



ASSISI - S. MARIA DEGLI ANGELI
Rruga Ermini - Tel. 075.8043431 Faks 075.8043770

Kopje e njëjtë me originalin c: 1 d'> :.,mento e•• bitomi dal l 1. l tj1E (\$,SA'T0

al quale dopo co1 l òt 10 1H-; u., f ;C_ è stato restituito.

Si rilascia per uso a richiesta dell'interessato.

fl- L l.....\$. , _.);>,.0. U. li 6, ?, , ..,IQ.Q.S .., ,
' Dott. Paolo Maria PETTINACCI talo

dosja 2406 Kopje për klientin aa. 2 nga 2

Nr. repertori 41770

Nr. Përmbledhës 27795

PROCESVERBALI I ASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHME TË SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
REPUBLIKA ITALIANE

Viti dymijë e njëzet, më datë nëntë të muajit qershor

(9.6.2020)

në ora 17:00

Në Bastia Umbra, Sheshi Cavour nr. 14, në studion time.

Përpara meje Dr. MARIO BIAVATI, Noter në Bastia Umbra, i regjistruar pranë Regjistratit të Distriktit të Noterëve të Peruxhias, u paraqit:

CALZONI FABIO lindur në Foligno (Peruxhia), më 10 qershor 1974, me banim në Assisi (Peruxhia), rruga Giuseppe Saragat nr. 122, me kod tatimor: CLZ FBA 74H10 D653K, qytetar italian, i cili deklaron se merr aktin e sipërcituar në emër të vet dhe të shoqërisë "SEKURITALIA S.R.L." me seli në Assisi, Santa Maria Degli Angeli, rruga dei Vetturali nr. 6, me kapital 144.000,00 Euro, me kod tatimor a numër regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve të Peruxhias: 02812080543, Regjistri Ekonomik Administrativ nr. 242618, numër TVSH 02812080543, në cilësinë e Administratorit të Vetëm dhe përfaqësuesit ligjor të së njëjtës, në përputhje me kompetencat që i njihen nga statuti i shoqërisë.

Pala e paraqitur në fjalë, për identitetin personal të të cilit unë si Noter jam i sigurt, më deklaron se në këtë orë, vend dhe datë është mbledhur, në përputhje me ligjin, asambleja e jashtëzakonshme e Shoqërisë "SEKURITALIA S.R.L." në formën e saj të plotë për të marrë vendimet e mëposhtme:

RENDI I DITËS

1) rritja e kapitalit të shoqërisë


dhe më kërkon mua Noterit që të marr aktin e sipërcituar.

Në përgjigje të kërkesës që mu bë, unë, Noteri, e marr procesverbalin në fjalë me anë të të cilit konfirmoj sa vijon:

Pala e pranishme merr kryesimin e mbledhjes së aksionarëve në përputhje me statutin duke konstatuar:

- a) pjesëmarrjen e ortakut të vetëm Calzoni Fabio, i cili është edhe zotëruesi i gjithë kapitalit të shoqërisë
- b) pjesëmarrjen e Administratorit të Vetëm në personin e palës së paraqitur
- c) pjesëmarrjen e Revizorit të Vetëm Di Muro Mariateresa

e deklaron ligjshëmrisht të mbledhur asamblenë në formën e saj të plotë, pasi që ortaku i vetëm ka shpallur njohjen e plotë të çështjes që gjendet në rendin e ditës dhe se nuk ka asnjë kundërshtim ndaj trajtimit të saj, dhe kështu pika e vendosur në rendin e ditës kalon për shqyrtim.



Presidenti i Asamblesë parashtron arsyet dhe motivet e lidhura me mundësinë për ta rritur kapitalin e shoqërisë nga 144.000,00 Euro në 200.000,00 Euro, pra, për një shumë prej 56.000,00 Euro, pa futur ndonjë kapital shtesë, duke përdorur një shumë të barabartë nga ajo që njihet si "Rezerva e Statutit", sipas gjendjes pasurore të referuar më 30 prill 2020.

Presidenti deklaron se kapitali i tanishëm i shoqërisë është plotësisht i lirë.

Pas një diskutimi të shkurtër dhe ndërhyrjes së ortakut, pikë kjo e vendosur në rendin e ditës, Asambleja

VENDOSI

1) të miratojë gjendjen pasurore të referuar më 30 prill 2020 që i bashkëngjitet dokumentit të sipërcituar si shtojca "A", me përjashtimin tim si noter nga leximi.

2) të rrisë kapitalin e shoqërisë nga 144.000,00 (njëqind e dyzetekatër mijë) Euro në 200.000,00 (dyqind mijë) Euro, pra, për pasojë për një shumë prej 56.000,00 (pesëdhjetegjashtë mijë) Euro, pa futur ndonjë kapital shtesë, përmes transferimit të shumës së barasvlershme nga "Rezervat e Statutit", të cilat rezultojnë nga gjendja pasurore, e bashkëngjitur këtij akti.

Për pasojë, zëri "Rezervat e Statutit" zvogëlohet në shumën 136.047,45 Euro.

Kapitali i shoqërisë pas operacionit të lartpërmendur rezulton që është 200.000,00 (dyqind mijë) Euro, plotësisht i lirë dhe nën zotërimin e z. Calzoni Fabio.

3) t'i bashkëngjisë këtij akti si shtojca "B", me përjashtimin tim si Noter nga leximi, statutin e shoqërisë, duke e bërë atë pjesë të këtij vendimi.

4) t'i delegojë palës së paraqitur të kryejë të gjitha ndryshimet, fshirjet dhe shtesat në këtë procesverbal dhe në statutin e bashkëlidhur, të cilat mund të jenë të nevojshme për regjistrimin e këtij akti.

Shpenzimet e këtij akti do të paguhen nga Shoqëria.

5) Palët, në përputhje me Dekretin Legjislativ nr. 196, më 30 qershor 2003, bien dakord për trajtimin e të dhënave të tyre personale, siç parashtrihen në këtë akt, të dhëna të cilat mund të bëhen pjesë e bazave të të dhënave, arkivave informatike dhe sistemeve telematike vetëm për qëllime të bashkëlidhura me procedurat e ndërvarura, përfshirë ato tatimore.

Asambleja u mbyll në ora 17:30, meqenëse nuk kishte ndonjë çështje tjetër për shqyrtim.

Dokument pjesërisht i daktilografuar në përputhje me ligjin nga një person të cilit i besoj dhe pjesërisht i shkruar në dorën time në dy kopje, secila me pesë faqe, procesverbal i cili iu lexua palës së paraqitur dhe që mori miratimin e saj, duke e nënshkruar dokumentin në ora 17:30

Nënshkruar nga Calzoni Fabio

Nënshkruar nga Noteri Mario Biavati

Shtojca B me Nr. Repertori 41770/27795

STATUTI i shoqërisë SEKURITALIA S.R.L."

PJESA I
EMËRTIMI – OBJEKTI – SELIA - KOHËZGJATJA

NENI 1) Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "SEKURITALIA S.R.L."

NENI 2) Selia e shoqërisë gjendet në Komunën e Bastia Umbra, në adresën që rezulton nga regjistrimi i bërë për këtë qëllim pranë Regjistrin të Ndërmarrjeve, në përputhje me Nenin 111 ter, dispozitat e vënies në zbatim të Kodit Civil italian. Organi administrativ ka të drejtën të themelojë, ndryshojë ose shpërbëjë, si në Itali ashtu edhe jashtë vendit, agjencisë, depozitat, degët dhe përfaqësitë.

NENI 3) Adresa zyrtare e ortakëve për sa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo që paraqitet në regjistrin e ortakëve.

NENI 4) Kohëzgjatja e shoqërisë është e caktuar deri më 31 dhjetor 2050 dhe mund të zgjatet ose edhe të shpërndalet përpara kësaj date me vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me ligjin.

NENI 5) Shoqëria ka si objekt të saj:

- Shitjen me pakicë dhe shumicë, dhënien me qira të produkteve dhe/ose materialeve (gjysmë të gatshme dhe/ose të gatshme), sistemeve dhe/ose impianteve të çdo lloji (ushqimore dhe joushqimore, zjarrfikëse, sanitare, elektronike, higjienike, kimike, elektrike, mekanike, teknike për sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe jo, objekte dhe veshje profesionale, publicitare dhe/ose industriale, për parandalimin e aksidenteve, sinjalistikën e çdo lloji, të videosurvejimit, citofonisë, videocitofonisë, të telekomandave, riparime, të telefonave, të videokonferencave, pajisje ngrohjeje, higjienike, ujë, sanitare, hidrosanitare, të kondicionimit të ajrit, energjetike, sportive) dhe shërbimeve të çdo lloji, marrjen e mandateve të agjencisë, me ose pa përfaqësim, vetëm apo me mandatarë të tjerë, për llogari të kompanive, ndërmarrjeve industriale, enteve publike dhe private, shoqatave, personave fizikë, italianë dhe të huaj, edhe me themelimin e degëve dhe jo, me ndihmën e ndërmjetësve dhe jo;

- Projektimin, koordinimin, planifikimin, administrimin, kontrollin si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur me ta, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, nga ndërtimi deri te shitja (në të gjitha format e vlefshme ligjore si brenda selisë ashtu edhe jashtë saj), si brenda ashtu edhe jashtë vendit, bashkë me ndërtimin e magazinave, dyqaneve të shitjes, agjencive dhe degëve, si dhe montimin, paketimin, ndërtimin, instalimin në kantier dhe mirëmbajtjen, gjithashtu sipas kontratës dhe/ose nënkontraktimit të produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme të çdo lloji, produkte ushqimore pa përfshirë çdo sistem, impiant, produkt dhe/ose material në sektorin e zjarrfikësve, duke përfshirë sinjalizimin dhe/ose shuarjen e zjarrit, sistemet sanitare, elektronike, higjienike, kimike, elektrike, mekanike, teknike për sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe jo, objektet dhe veshje

profesionale, reklamuese dhe/ose industriale, për parandalimin i aksidenteve, çdo lloj sinjalistike, videosurvejimi, citofonie, videocitofonie, telekomande, pastrimi, telefonie, videokonferencash, pajisje ngrohjeje, energji dhe gaz, higjienike, ujë, sanitare, hidrosanitare, të kondicionimit të ajrit, sportive dhe elektrike.

- Projektimin, ndërtimin, modifikimin, montimin, riparimin si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur me ta, i supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm dhe në veçanti instalimin dhe mirëmbajtjen e çdo mjeti, pajisjeje dhe/ose mjeti zjarrfikës ose sigurie dhe parandalimi aksidentesh në përgjithësi.

- Riparimin e makinave, transformimin dhe/ose ndërtimin e automjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve zjarrfikëse.

- Menaxhimin dhe organizimin, si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, i supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm, i shërbimeve të zjarrfikësve me rastin e panireve tregtare, garave sportive, shfaqjeve dhe eventeve të të gjitha llojeve.

- Ofrimin e shërbimeve të të gjitha llojeve dhe tipave, si dhe të çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, duke përfshirë lidhjen e kontratave dhe/ose nënkontratave, në shërbim të individëve, kompanive, shoqatave, enteve publike dhe private, të të gjitha produkteve të referuara në objektin e shoqërisë, duke përfshirë të gjitha procedurat, duke filluar me projektimin e vazhduar me përmasimin dhe me klasifikimin, duke përfshirë kolaudimin, të:

- Sistemeve elektrike – përfshirë këtu identifikimin e vendeve me rrezik shpërthimi, paneleve elektrike të tensionit të mesëm dhe të ulët, konsulencë për kontroll të tokëzimi, projektim rrjetesh të tensionit të mesëm, kabinave të transformatorëve, sistemeve elektrike civile dhe industriale, impianteve me sistem BUS, impianteve të transmetimit të të dhënave dhe zërit, rrjeteve LAN, sistemeve të shpërndarjes së zërit;

- Sistemeve mekanike dhe sistemeve të ngrohjes të çdo lloji, sistemeve për kondicionimin, ajrimin dhe/ose termoventilimin, sistemeve hidraulike, sanitare dhe të shkarkimit, sistemeve të magazinimit, transportit dhe shpërndarjes, për përdorim civil dhe/ose industrial, të lëngjeve, vajrave, lëndëve djegëse, naftës, sistemeve pneumatike, të ajrit të kompresuar, gazrave mjekësore, gazrave të djegshme, oksiacetilenit, sistemeve hidraulike për përdorim industrial, sistemeve të e prodhimit dhe shpërndarjes së avullit për përdorim industrial;

- Parandalimit të zjarrit me sisteme manuale të fikjes së zjarrit me hidrantë dhe/ose bobina, sisteme automatike të fikjes së zjarrit duke përfshirë spërkatës, sisteme automatike të zbulimit të zjarrit, projekte dhe/ose verifikime dhe vlerësime të betuara për lëshimin dhe/ose rinovimin e certifikatës për parandalimin e zjarrit;

- Kolaudimin dhe kontrollin instrumental të sistemeve teknologjike, kontrollet fillestare dhe periodike të sistemeve elektrike edhe për klinika mjekësore dhe të ngjashme, civile dhe industriale, kontrollet e sistemeve elektrike, kontrollet e centraleve dhe veglave të makinerive, kontrollet e sigurisë elektrike të makinerive dhe kuadreve të BT (AS dhe ANS), kolaudimit të sistemeve termo-hidraulike;

- Vlerësimet për markimin CE të makinerive dhe/ose sistemeve të ndryshme, përshtatjen e makinerive me rregulloret, këshilla teknike lidhur me direktivën e makinerive dhe për aplikimin e markimit CE duke përfshirë certifikimin sipas direktivës së makinerive;

- Projektimin inxhinierik, ndërtimor dhe gjeoteknik, arkitektonik dhe interior, llogaritjen e konstruksioneve prej çeliku, murature, të përziara, me beton arme dhe beton arme të parakompresuar, të themeleve dhe punimeve tokësore, kontrollet e qëndrueshmërisë së tokës dhe shkëmbinjve, konsolidimin, rikonstruktimin, restaurimin ruajtës, llogaritjet metrike vlerësuese;

- Hartimin dhe menaxhimin e të gjitha procedurave për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve në vendin e punës duke përfshirë dokumentin e vlerësimit të rrezikut të kërkuar nga Dekreti Legjislativ 626/94, duke përfshirë kontrollet e temperaturës dhe lagështisë për mjediset civile dhe industriale, hetimet mikroklimatike në mjediset e punës, përpunimin e dokumenteve, vlerësimin e rrezikut nga zjarri dhe planin e emergjencës dhe evakuimit, përpunimin e dokumenteve të rrezikut të shkarkimeve atmosferike, përpunimin e dokumenteve të rrezikut të shpërthimit, koordinimin e hartimit të planit dhe sigurinë në kantieret e ndërtimit, hartimin e planit të sigurisë operative, koordinimin për projektimin dhe ekzekutimin e shesheve të ndërtimit, zbulimin instrumental të zhurmës për vlerësimin e ekspozimit të punëtorëve, si dhe monitorimin e ndikimit mjedisor në ambiente civile dhe industriale, përfshirë këtu ato të jashtme dhe për banim, llogaritjen e rrezikut kimik, dokumentacionin, vlerësimet inxhinierike të ndriçimit, analizat e vendeve të punës në терминаlet video, projektimin dhe riparimin e mjediseve të punës, analizat e pluhurit, mbikëqyrjen shëndetësore, ekzaminime mjekësore dhe çdo shërbim dhe/ose aktivitet tjetër përkatës, të supozuar dhe në çdo rast të nevojshëm për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- Konsulencën, menaxhimin, koordinimin, tutorimin, mësimdhënien, asistencën dhe/ose organizimin, si dhe çdo lloj aktiviteti të ndërlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, përfshirë edhe lidhjen e kontratave dhe/ose nënkontratave, të kurseve të trajnimit të përgjithshëm që synojnë sektorin publik dhe privat, kurse të cilat janë teorike dhe praktike, me në qendër përgjithësisht sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës, duke përfshirë edhe kurse trajnimi për drejtuesin e shërbimit të parandalimit dhe mbrojtjes në punë, trajnime për punonjësit e ndihmës së parë, trajnime për zjarrfikësit dhe menaxhimin e emergjencave me rrezik të ulët dhe të mesëm, trajnime dhe informacion për punëtorët, trajnime për punëtorët që i nënshtrohen rrezikut të shpërthimit, sistemet e certifikimit të kompanisë, cilësisë mjedisore dhe HACCP, shitjet dhe marketingun, përzgjedhjen, menaxhimin, administrimin, kualifikimin dhe rritjen profesionale të burimeve njerëzore dhe menaxhimin e strukturave të shitjes.

- Të drejtën për të mundur realizimin e objektit të korporatës nëpërmjet tipave të reklamimit të çdo forme dhe lloji duke përfshirë mbajtjen e kongreseve, seminareve, programeve master dhe të ngjashme, si dhe të çdo nisme tjetër të përshtatshme për arritjen dhe promovimin e objektit të korporatës.

- Projektet e trajnimit dhe/ose shërbimet e asistencës, si dhe çdo lloj aktiviteti të ndërlidhur, të supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm, edhe në emër të personave të tjerë juridikë, për përfitimin e donacioneve publike dhe/ose private në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.

- Impiantet për prodhimin, transportin dhe përdorimin e energjisë, përfshirë këtu energjinë elektrike, duke përfshirë shpërndarjen dhe shitjen, duke përfshirë trajtimin, përdorimin, akumulimin dhe konsumin e ujit dhe ajrit brenda ndërtesave, duke përfshirë montimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin përkatës të sistemet përkatëse si dhe çdo lloj aktiviteti të lidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm.

- Botimin dhe shitjen (në të gjitha format e vlefshme ligjore, brenda dhe jashtë selisë së saj) të botimeve në përgjithësi - libra, revista, kancelari dhe artikuj të ngjashëm - si dhe të çdo produkti botues, duke përfshirë gazetat dhe revistat periodike, menaxhimin e librarive dhe agjencive të librave më vete dhe për llogari të palëve të treta si dhe çdo lloj veprimtarie të lidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishme.

- Çdo lloj veprimtarie që lidhet me përdorimin e e-commerce në internet, faqet e internetit, hostimin dhe teknologjinë e informacionit duke përfshirë programimin, zbatimin, menaxhimin, mirëmbajtjen si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishme.

- Objekti i korporatës përfshin gjithashtu blerjen, shitjen dhe tregtimin me çfarëdolloj të drejte (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) të pasurive të paluajtshme dhe tërësisë së pasurive të luajtshme; marketimin në çdo formë të të gjitha produkteve në sektorin joushqimor.

Veç kësaj, shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, prodhuese, bankare, industriale dhe financiare, kreditore, në letra me vlerë dhe pasuri të paluajtshme, të cilat organi administrativ i konsideron të nevojshme ose të nevojshme për arritjen e qëllimit të korporatës ose në çdo rast të bashkëlidhura me të, duke përfshirë blerjen të aksioneve ose të pjesëve në shoqëri të tjera me qëllim të ngjashëm ose të njëjtë.

Shoqëria mund të japë gjithashtu fidejuzione dhe garanci reale në favor të të tretëve, subjekteve, personave fizikë e juridikë dhe bankave si dhe në favor të vetë aksionarëve.

PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË - KUOTAT

NENI 6) Kapitali i shoqërisë është 10000 (dhjetë mijë) Euro i ndarë në aksione me vlerë nominale nga një euro secila.

Në rast të rritjes së kapitalit aksionar, e drejta e optionit të blerjes u rezervohet ortakëve.

Shoqëria mund të marrë, edhe nëse nuk miratohet nga asambleja, paradhënie nga ortakët për rritje të ardhshme të kapitalit aksionar në një mënyrë rreptësisht proporcionale me kapitalin aksionar të nënshkruar nga secili prej tyre; asnjë interes nuk mund të kërkohet për këto kredi.

Shoqëria nuk është e detyruar të zbatojë rritjen e kapitalit aksionar brenda një periudhe të caktuar dhe do të mund të kthejë paradhëniet e marra, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve dhe nevojave të likuiditetit të saj.

Ortakët mund t'i japin shoqërisë edhe hua pa interes dhe me interes me kërkesë të organit administrativ, si dhe në mënyrë jo proporcionale me kapitalin aksionar të nënshkruar.

Shoqëria mund të marrë gjithashtu fonde me detyrim shlyerje nga ortakët, pa kryer një grumbullim kursimesh nga publiku, në përputhje me kufijtë dhe kriteret e përcaktuara nga Komiteti Ndërmintor për Kreditë dhe Kursimet me rezolutën e datës 3 mars 1994 (dhe çdo ndryshim tjetër të mëvonshëm), në zbatim të dispozitave të nenit 11 të Dekretit Legjislativ nr. 385, më 1 shtator 1993 (Ligji i Konsoliduar për bankat dhe kredinë).

NENI 7) Aksionet janë të transferueshme si përmes transaksioneve inter vivos ashtu edhe përmes atyre mortis causa dhe e drejta e parablerjes u rezervohet ortakëve në të njëjtat kushte.

Kjo e drejtë nuk funksionon në rast të transferimit të aksioneve ortakëve të tjerë ose shoqërive në të cilat kanë pjesë të njëjtët ortakë.

Në rast vdekjeje të një ortaku, ortakët që janë gjallë kanë të drejtë t'ia blejnë trashëgimtarëve pjesën e të ndjerit.

Ortaku që vendos të shesë aksionet e tij ose një pjesë të tyre përmes transaksioneve inter vivos duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë për këtë vendim të tij përmes një letre rekomande me vërtetim marrjeje të dërguar në adresën e treguar në regjistrin e ortakëve, duke i njoftuar ata për çmimin e kërkuar ose vlerën e aksioneve.

Brenda afatit prej tridhjetë ditësh nga ky njoftim, ortakët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në përpjesëtim me aksionet e zotëruara dhe sërish me letër rekomande me vërtetim marrjeje t'ia njoftojnë vendimin e tyre ortakut që po shet aksionet.

Nëse njëri prej ortakëve vendos të mos e ushtrojë të drejtën e parablerjes, kjo e drejtë mund të ushtrohet proporcionalisht nga ortakët e tjerë.

Në mungesë të një marrëveshjeje, vlera e aksioneve do të përcaktohet nga Arbitri që do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës brenda juridiksionit të së cilës gjendet selia e shoqërisë.

Shitësi i aksioneve ka të drejtë të heqë dorë nga transferimi i kërkuar, duke iu shmangur ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nëse vlerëson se çmimi i vendosur nga arbitri është i pamjaftueshëm.

Në rast të mosrespektimit të rregullave të përcaktuara nga ky nen, shitja do të jetë e pavlefshme në raport me Shoqërinë.

Procedura e parashikuar në këtë nen nuk zbatohet në rastin e kalimit të aksioneve tek bashkëshorti, fëmijët dhe pasardhësit e drejtpërdrejtë të ortakut shitës, meqenëse nuk ka asnjë kufizim për këtë transaksion.

PJESA III ASAMBLETË

NENI 9) Asamblatë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ortakëve do të thirren nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Këshillit të Administrimit me letër rekomande me vërtetim marrjeje, e cila iu dërgohet ortakëve në adresën e treguar në regjistrin e ortakëve ose me çdo mjet tjetër të përshtatshëm për këtë qëllim (faks, e-mail ose mjet të ngjashëm), të paktën tetë ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Letra duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e takimit dhe listën e çështjeve që do të diskutohen.

E njëjta letër do të tregojë vendin, datën dhe orën e sesionit të dytë të asamblesë, nëse i pari nuk arrin pjesëmarrjen e kërkuar nga Statuti.

Do të jenë sidoqoftë të vlefshme asamblatë e ortakëve, edhe nëse nuk thirren si më sipër, nëse në to përfaqësohet i gjithë kapitali aksionar dhe marrin pjesë të gjithë administratorët dhe revizorët, nëse janë emëruar, ose informohen dhe askush nuk kundërshton; megjithatë, në këtë rast, secili nga të pranishmit mund të kundërshtojë trajtimin e çështjeve për të cilat nuk e konsiderojnë veten të informuar.

NENI 10) Asambleja do të thirret sa herë që vlerësohet e përshtatshme nga Administratori i Vetëm ose Kryetari i Këshillit të Administrimit; sidoqoftë, të paktën një herë në vit duhet të mbledhet në sesion të zakonshëm brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga përfundimi i vitit financiar ose brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kur lind një nevojë e veçantë, për miratimin e pasqyrave financiare dhe të akteve të tjera të shoqërisë, dhe duhet të mbledhet sapo të jetë e mundur, brenda pesëmbëdhjetë ditëve, nëse kjo gjë kërkohet nga një numër ortakësh që zotërojnë të paktën një të pestën e kapitalit aksionar.

REPU
711

NENI 11) Si President i Asamblesë caktohet Administratori i Vetëm apo Kryetari i Këshillit të Administrimit; në rast se këta mungojnë, caktohet Zëvendëskryetari i Këshillit të Administrimit, ndërsa në rast se të gjithë këta mungojnë apo kanë ndonjë pengesë çfarëdo, për këtë qëllim caktohet një ortak i zgjedhur nga pjesëmarrësit e pranishëm.

NENI 12) Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet në të edhe prej një personi që nuk është ortak duke paraqitur një prokurë me shkrim, me kusht që ky i fundit të mos jetë administrator, revizor, apo i punësuar i shoqërisë.

NENI 13) Vendimet e asamblesë do të paraqiten në procesverbalin e hartuar në të njëjtën kohë në regjistrin e shoqërisë nën përgjegjësinë e Presidentit dhe nga një sekretar, i caktuar nga Presidenti me miratimin e asamblesë edhe ndër ata nuk janë ortakë, me kusht që të dyja palët ta kenë miratuar atë, përveç rasteve kur procesverbali me kërkesë të Presidentit apo të Asamblesë apo në përputhje me ligjin duhet të hartohet nga një Noter.

NENI 14) Vendimet e asambleve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme merren në sesionin e parë me votën e favorshme të atyre ortakëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë.

Në sesionin e dytë, vendimet e asambleve qofshin këto të zakonshme apo të jashtëzakonshme merren me shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë të pranishëm ose të përfaqësuar, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

NENI 15) Vendimet e ortakëve mund të merren edhe me metodën e konsultimit me shkrim ose të miratimit të shprehur me shkrim, me përjashtim të rasteve kur në përputhje me ligjin apo me statutin në fjalë është i detyrueshëm përdorimi i metodës së votimit në asamble.

PJESA IV

ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

NENI 16) Shoqëria drejtohet nga një Administrator i vetëm ose nga një Këshill Administrimi i përbërë nga një numër i ndryshueshëm anëtarësh, minimumi dy dhe maksimumi shtatë, siç përcaktohet në vendimet e herëpashershme të asamblesë, organ i cili do të jetë përgjegjës në një rast të dytë edhe për emërimin e Kryetarit.

Organi administrativ zgjidhet për herë të parë në aktin e themelimit.

Administratori i vetëm ose Këshilli i Administrimit mund të rizgjidhen dhe qëndrojnë në detyrë për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar të vendosur në çastin e emërimit, ose derisa të revokohen nga asambleja, ose për shkak të dorëheqjes, mbarimit të mandatit a vdekjes.

Administratorët mund të mos jenë ortakë të shoqërisë.

NENI 17) Organi administrativ zotëron kompetencat më të gjera të mundshme për administrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që i çmon të përshtatshme për zbatimin dhe arritjen e objektit të shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji i parashikon rreptësisht për asamblenë.

NENI 18) Organit administrativ i takon përfaqësimi ligjor i shoqërisë përpara të palëve të treta dhe në gjykatë, me të drejtën e kryerjes së veprimeve dhe të paraqitjes së akteve gjyqësore dhe administrative.

Administratori i vetëm ose Kryetari i Këshillit të Administrimit, të cilët gëzojnë të drejtën për të nënshkruar në emër të shoqërisë, mund të emërojnë një ose më shumë përfaqësues ligjorë, duke përcaktuar kompetencat e tyre.

Këshilli i Administrimit mund t'i delegojë Kryetarit ose Zëvendëskryetarit, apo një ose më shumë Anëtarëve të Këshillit, të gjitha kompetencat që mund të delegohen sipas ligjit, por mund t'ia delegojnë detyrat e shoqërisë edhe palëve të treta, qofshin këta ortakë apo jo.

NENI 19) Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për shkak të detyrës së tyre.

Asambleja mund të caktojë gjithashtu një kompensim vjetor për administratorët.

Ortakët gjithashtu mund të vendosin një kuotë vjetore që do të ndahet si kompensim për ndërprerjen e mandatit të administratorëve në përputhje me dispozitat e Ligjit të Konsoliduar për Tatimet mbi të ardhurat, Neni 105, Paragrafi IV (Dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 917, më 22/12/1986) edhe nëpërmjet përcaktimit të policave të sigurimit që trajtojnë përfundimin e mandatit.

NENI 20) Këshilli i Administrimit, nëse emërohet, mbledhet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe gjetkë, sa herë që Kryetari i tij e gjykon të nevojshme ose edhe kur kërkohet qoftë nga një anëtar i vetëm.

NENI 21) Thirrja e mbledhjes e Këshillit të Administrimit mund të bëhet nga Kryetari i tij pesë ditë përpara datës së caktuar, edhe me telegram të dërguar të paktën dy ditë para mbledhjes në banesën e çdo anëtari të tij.

NENI 22) Vendimet e Këshillit të Administrimit mund të merren edhe me metodën e konsultimit me shkrim ose me miratimin e shprehur me shkrim, me përjashtim të rasteve kur në përputhje me ligjin ose me këtë statut, përdorimi i metodës së asamblesë është i detyrueshëm.

NENI 23) Lipset prania e shumicës së anëtarëve në detyrë që vendimet e Këshillit të Administrimit të jenë të vlefshme.


Vendimet merren me shumicë absolute të votave të të pranishmëve. Nëse Këshilli i Administrimit përbëhet nga më shumë se dy anëtarë, vota e Kryetarit mbizotëron në rast barazie votash.

NENI 24) Regjistri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Këshillit të Administrimit mbahet nga Kryetari i këtij Këshilli.

PJESA V KOLEGJI SINDAKAL DHE REVIZORI

NENI 25) Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet Kolegjit Sindakal ose një Revizori.

Kolegji Sindakal, kur kërkohet nga asambleja ose me ligj, do të përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy zëvendësues, që të gjithë të emëruar nga asambleja, nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryetari i Kolegjit Sindakal.



Anëtarët e Këshillit ose Revizori qëndrojnë në detyrë për tre vjet.
Asambleja përcakton edhe shpërblimin që i takon anëtarëve të Këshillit Sindakal ose revizorit.

PJESA VI PËRJASHTIMI

NENI 26) Në rastin e një ortaku, i cili për shkak të një detyrimi kontribues detyrohet të ofrojë punë ose shërbime në favor të shoqërisë, ky i fundit mund të përjashtohet prej detyrimit në fjalë nëse nuk është më në gjendje që të ofrojë punën ose shërbimet që parashikon detyrimi.

Mund të përjashtohet gjithashtu një ortak që është përjashtuar, ka shpallur falimentimin ose që është dënuar me një vendim të formës së prerë që parashikon si dënim ndalimin e të drejtës për të ushtruar funksione publike.

PJESA VII BILANCI DHE ASETET

NENI 27) Viti financiar përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Viti i parë financiar do të mbyllet më 31 dhjetor 2005.

Në fund të çdo viti financiar, organi administrativ do të procedojë me përgatitjen e bilancit të shoqërisë që do të hartohet në përputhje me ligjin.

NENI 28) Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare të miratuara nga asambleja do të ndahen si më poshtë:

- 5% (pesë për qind) në rezervën e zakonshme derisa të arrihet një e pesta e kapitalit të shoqërisë;
- pjesa e mbetur në dispozicion të ortakëve, përveç rastit kur asambleja vendos të ndajë të gjithë atë ose një pjesë të saj për provizione në favor të rezervave të veçanta.

PJESA VIII SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI

NENI 29) Kur merr vendimin për shpërndarjen e shoqërisë në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, mbledhja e jashtëzakonshme e ortakëve do të përcaktojë edhe procedurat e likuidimit dhe do të emërojë një ose më shumë likuidues, duke vendosur kompetencat dhe kompensimin e tyre.

PJESA IX TITUJT E BORXHIT

NENI 30) Shoqëria mund të emetojë tituj borxhi në mënyrat dhe brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

Emetimi miratohet nga asambleja e ortakëve me atë shumicë votash që parashikohet për ndryshimin e këtij statuti.

PJESA X MOSMARRËVESHJET

NENI 31) Zgjidhja e çdo mosmarrëveshjeje sa i përket të drejtave të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e shoqërisë do t'i paraqitet një paneli arbitrazhi të përbërë nga tre arbitra, të cilët do të emërohen nga një palë e tretë jashtë shoqërisë, dhe në marrëveshje të ndërsjellë mes palëve ose, në mungesë të një marrëveshjeje, nga Kryetari i Gjykatës së Peruxhias.

Kolegji i Arbitrazhit do të vendosë për çështjet e mosmarrëveshjeve sipas ligjit.

NENI 32) Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut dhe në aktin e themelimit palët do t'i drejtohen Kodit Civil dhe ligjeve të veçanta në fuqi që rregullojnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.

MODELI I PËRBASHKËT INFORMATIK – AKT I LËSHUAR NË PROCESIN E REGJISTRIMIT PËR PËRDORIM TË REGJISTRIT TË NDËRMARRJEVE. KOPJE E LËSHUAR ME MBËSHTETJE INFORMATIKE NË PËRPTHJE ME DOKUMENTIN FILLESTAR NË LETËR, NË PËRPTHJE ME NENIN 20 TË DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 445/2000.

TAKSA POSTALE ËSHTË SHLYER NË PËRPTHJE ME DEKRETIN 22/02/2007 PËRMES MODELIT TË PËRBASHKËT INFORMATIK.

Nr. repertori 41770

Nr. Përmbledhës 27795

PROCESVERBALI I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
REPUBLIKA ITALIANE

Viti dymijë e njëzet, më datë nëntë të muajit qershor

(9.6.2020)

në ora 17:00

Në Bastia Umbra, Sheshi Cavour nr. 14, në studion time.

Përpara meje Dr. MARIO BIAVATI, Noter në Bastia Umbra, i regjistruar pranë Regjistrin të Distriktit të Noterëve të Peruxhias, u paraqit:

CALZONI FABIO lindur në Foligno (Peruxhia), më 10 qershor 1974, me banim në Assisi (Peruxhia), rruga Giuseppe Saragat nr. 122, me kod tatimor: CLZ FBA 74H10 D653K, qytetar italian, i cili deklaroi se merr aktin e sipërcituar në emër të vet dhe të shoqërisë "SEKURITALIA S.R.L." me seli në Assisi, Santa Maria Degli Angeli, rruga dei Vetturali nr. 6, me kapital 144.000,00 Euro, me kod tatimor a numër regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve të Peruxhias: 02812080543, Regjistri Ekonomik Administrativ nr. 242618, numër TVSH 02812080543, në cilësinë e Administratorit të Vetëm dhe përfaqësuesit ligjor të së njëjtës, në përputhje me kompetencat që i njihen nga statuti i shoqërisë.

Pala e paraqitur në fjalë, për identitetin personal të të cilit unë si Noter jam i sigurt, më deklaroi se në këtë orë, vend dhe datë është mbledhur, në përputhje me ligjin, asambleja e jashtëzakonshme e Shoqërisë "SEKURITALIA S.R.L." në formën e saj të plotë për të marrë vendimet e mëposhtme:


RENDI I DITËS

1) rritja e kapitalit të shoqërisë

dhe më kërkon mua Noterit që të marr aktin e sipërcituar.

Në përgjigje të kërkesës që mu bë, unë, Noteri, e marr procesverbalin në fjalë me anë të të cilit konfirmoj sa vijon:

Pala e pranishme merr kryesimin e mbledhjes së aksionarëve në përputhje me statutin duke konstatuar:

- 
- a) pjesëmarrjen e ortakut të vetëm Calzoni Fabio, i cili është edhe zotëruesi i gjithë kapitalit të shoqërisë
 - b) pjesëmarrjen e Administratorit të Vetëm në personin e palës së paraqitur
 - c) pjesëmarrjen e Revizorit të Vetëm Di Muro Mariateresa

e deklaron ligjshëmrisht të mbledhur asamblenë në formën e saj të plotë, pasi që ortaku i vetëm ka shpallur njohjen e plotë të çështjes që gjendet në rendin e ditës dhe se nuk ka asnjë kundërshtim ndaj trajtimit të saj, dhe kështu pika e vendosur në rendin e ditës kalon për shqyrtim.

Presidenti i Asamblesë parashton arsyet dhe motivet e lidhura me mundësinë për ta rritur kapitalin e shoqërisë nga 144.000,00 Euro në 200.000,00 Euro, pra, për një shumë prej 56.000,00 Euro, pa futur ndonjë kapital shtesë, duke përdorur një shumë të barabartë nga ajo që njihet si "Rezerva e Statutit", sipas gjendjes pasurore të referuar më 30 prill 2020.

Presidenti deklaron se kapitali i tanishëm i shoqërisë është plotësisht i lirë.

Pas një diskutimi të shkurtër dhe ndërhyrjes së ortakut, pikë kjo e vendosur në rendin e ditës, Asambleja

VENDOSI

- 1) të miratojë gjendjen pasurore të referuar më 30 prill 2020 që i bashkëngjitet dokumentit të sipërcituar si shtojca "A", me përjashtimin tim si noter nga leximi.
- 2) të rrisë kapitalin e shoqërisë nga 144.000,00 (njëqind e dyzetekatër mijë) Euro në 200.000,00 (dyqind mijë) Euro, pra, për pasojë për një shumë prej 56.000,00 (pesëdhjetegjashtë mijë) Euro, pa futur ndonjë kapital shtesë, përmes transferimit të shumës së barasvlershme nga "Rezervat e Statutit", të cilat rezultojnë nga gjendja pasurore, e bashkëngjitur këtij akti.
Për pasojë, zëri "Rezervat e Statutit" zvogëlohet në shumën 136.047,45 Euro.
Kapitali i shoqërisë pas operacionit të lartpërmendur rezulton që është 200.000,00 (dyqind mijë) Euro, plotësisht i lirë dhe nën zotërimin e z. Calzoni Fabio.
- 3) t'i bashkëngjisë këtij akti si shtojca "B", me përjashtimin tim si Noter nga leximi, statutin e shoqërisë, duke e bërë atë pjesë të këtij vendimi.

4) t'i delegojë palës së paraqitur të kryejë të gjitha ndryshimet, fshirjet dhe shtesat në këtë procesverbal dhe në statutin e bashkëlidhur, të cilat mund të jenë të nevojshme për regjistrimin e këtij akti. Shpenzimet e këtij akti do të paguhen nga Shoqëria.

5) Palët, në përputhje me Dekretin Legjislativ nr. 196, më 30 qershor 2003, bien dakord për trajtimin e të dhënave të tyre personale, siç parashtrohen në këtë akt, të dhëna të cilat mund të bëhen pjesë e bazave të të dhënave, arkivave informatike dhe sistemeve telematike vetëm për qëllime të bashkëlidhura me procedurat e ndërvarura, përfshirë ato tatimore.

Asambleja u mbyll në ora 17:30, meqenëse nuk kishte ndonjë çështje tjetër për shqyrtim.

Dokument pjesërisht i daktilogruar në përputhje me ligjin nga një person të cilit i besoj dhe pjesërisht i shkruar në dorën time në dy kopje, secila me pesë faqe, procesverbal i cili iu lexua palës së paraqitur dhe që mori miratimin e saj, duke e nënshkruar dokumentin në ora 17:30

Nënshkruar nga Calzoni Fabio
Nënshkruar nga Noteri Mario Biavati

Shtojca B me Nr. Repertori 41770/27795

STATUTI i shoqërisë SEKURITALIA S.R.L."

PJESA I

EMËRTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHËZGJATJA

NENI 1) Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "SEKURITALIA S.R.L."

NENI 2) Selia e shoqërisë gjendet në Komunën e Bastia Umbra, në adresën që rezulton nga regjistrimi i bërë për këtë qëllim pranë Regjistratit të Ndërmarrjeve, në përputhje me Nenin 111 ter, dispozitat e vënies në zbatim të Kodit Civil italian.

Organi administrativ ka të drejtën të themelojë, ndryshojë ose shpërbëjë, si në Itali ashtu edhe jashtë vendit, agjencisë, depozitat, degët dhe përfaqësitë.

NENI 3) Adresa zyrtare e ortakëve për sa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo që paraqitet në regjistrin e ortakëve.

NENI 4) Kohëzgjatja e shoqërisë është e caktuar deri më 31 dhjetor 2050 dhe mund të zgjatet ose edhe të shpërndalet përpara kësaj date me vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me ligjin.

NENI 5) Shoqëria ka si objekt të saj:

- Shitjen me pakicë dhe shumicë, dhënien me qira të produkteve dhe/ose materialeve (gjysmë të gatshme dhe/ose të gatshme), sistemeve dhe/ose impianteve të çdo lloji (ushqimore dhe joushqimore, zjarrfikëse, sanitare, elektronike, higjienike, kimike, elektrike, mekanike, teknike për sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe jo, objekte dhe veshje profesionale, publicitare dhe/ose industriale, për parandalimin e aksidenteve, sinjalistikën e çdo lloji, të videosurvejimit, citofonisë, videocitofonisë, të telekomandave, riparime, të telefonave, të videokonferencave, pajisje ngrohjeje, higjienike, ujë, sanitare, hidrosanitare, të kondicionimit të ajrit, energjetike, sportive) dhe shërbimeve të çdo lloji, marrjen e mandateve të agjencisë, me ose pa përfaqësim, vetëm apo me mandatarë të tjerë, për llogari të kompanive, ndërmarrjeve industriale, enteve publike dhe private, shoqatave, personave fizikë, italianë dhe të huaj, edhe me themelimin e degëve dhe jo, me ndihmën e ndërmjetësve dhe jo;

- Projektimin, koordinimin, planifikimin, administrimin, kontrollin si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur me ta, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, nga ndërtimi deri te shitja (në të gjitha format e vlefshme ligjore si brenda selisë ashtu edhe jashtë saj), si brenda ashtu edhe jashtë vendit, bashkë me ndërtimin e magazinave, dyqaneve të shitjes, agjencive dhe degëve, si dhe montimin, paketimin, ndërtimin, instalimin në kantier dhe mirëmbajtjen, gjithashtu sipas kontratës dhe/ose nënkontraktimit të produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme të çdo lloji, produkte ushqimore pa përfshirë çdo sistem, impiant, produkt dhe/ose material në sektorin e zjarrfikësve, duke përfshirë sinjalizimin dhe/ose shuarjen e zjarrit, sistemet sanitare, elektronike, higjienike, kimike, elektrike, mekanike, teknike për sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe jo, objektet dhe veshje profesionale, reklamuese dhe/ose industriale, për parandalimin i aksidenteve, çdo lloj sinjalistike, videosurvejimi, citofonie, videocitofonie, telekomande, pastrimi, telefonie, videokonferencash, pajisje ngrohjeje, energji dhe gaz, higjienike, ujë, sanitare, hidrosanitare, të kondicionimit të ajrit, sportive dhe elektrike.

- Projektimin, ndërtimin, modifikimin, montimin, riparimin si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur me ta, i supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm dhe në veçanti instalimin dhe mirëmbajtjen e çdo mjeti, pajisjeje dhe/ose mjeti zjarrfikës ose sigurie dhe parandalimi aksidentesh në përgjithësi.

- Riparimin e makinave, transformimin dhe/ose ndërtimin e automjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve zjarrfikëse.

- Menaxhimin dhe organizimin, si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, i supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm, i shërbimeve të zjarrfikësve me rastin e panairove tregtare, garave sportive, shfaqjeve dhe eventeve të të gjitha llojeve.

- Ofrimin e shërbimeve të të gjitha llojeve dhe tipave, si dhe të çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, duke përfshirë lidhjen e kontratave dhe/ose nënkontratave, në shërbim të individëve, kompanive, shoqatave, enteve publike dhe private, të të gjitha produkteve të referuara në objektin e shoqërisë, duke përfshirë të gjitha procedurat, duke filluar me projektimin e vazhduar me përmasimin dhe me klasifikimin, duke përfshirë kolaudimin, të:

- Sistemeve elektrike - përfshirë këtu identifikimin e vendeve me rrezik shpërthimi, paneleve elektrike të tensionit të mesëm dhe të ulët, konsulencë për kontrollin tokëzimi, projektim rrjetesh të tensionit të mesëm, kabinave të transformatorëve, sistemeve elektrike civile dhe industriale, impianteve me sistem BUS, impianteve të transmetimit të të dhënave dhe zërit, rrjeteve LAN, sistemeve të shpërndarjes së zërit;

- Sistemeve mekanike dhe sistemeve të ngrohjes të çdo lloji, sistemeve për kondicionimin, ajrimin dhe/ose termoventilimin, sistemeve hidraulike, sanitare dhe të shkarkimit, sistemeve të magazinimit, transportit dhe shpërndarjes, për përdorim civil dhe/ose industrial, të lëngjeve, vajrave, lëndëve djegëse, naftës, sistemeve pneumatike, të ajrit të kompresuar, gazrave mjekësore, gazrave të djegshme, oksiacetilenit, sistemeve hidraulike për përdorim industrial, sistemeve të e prodhimit dhe shpërndarjes së avullit për përdorim industrial;

- Parandalimit të zjarrit me sisteme manuale të fikjes së zjarrit me hidrantë dhe/ose bobina, sisteme automatike të fikjes së zjarrit duke përfshirë spërkatës, sisteme automatike të zbulimit të zjarrit, projekte dhe/ose verifikime dhe vlerësime të betuara për lëshimin dhe/ose rinovimin e certifikatës për parandalimin e zjarrit;

- Kolaudimin dhe kontrollin instrumental të sistemeve teknologjike, kontrollet fillestare dhe periodike të sistemeve elektrike edhe për klinika mjekësore dhe të ngjashme, civile dhe industriale, kontrollet e sistemeve elektrike, kontrollet e centraleve dhe veglave të makinerive, kontrollet e sigurisë elektrike të makinerive dhe kuadreve të BT (AS dhe ANS), kolaudimit të sistemeve termo-hidraulike;

- Vlerësimet për markimin CE të makinerive dhe/ose sistemeve të ndryshme, përshtatjen e makinerive me rregulloret, këshilla teknike lidhur me direktivën e makinerive dhe për aplikimin e markimit CE duke përfshirë certifikimin sipas direktivës së makinerive;

- Projektimin inxhinierik, ndërtimor dhe gjeoteknik, arkitektonik dhe interior, llogaritjen e konstruksioneve prej çeliku, murature, të përziara, me beton arme dhe beton arme të parakompresuar, të themeleve dhe punimeve

tokësore, kontrollet e qëndrueshmërisë së tokës dhe shkëmbinjve, konsolidimin, rikonstruktimin, restaurimin ruajtës, llogaritjet metrike vlerësuese;

- Hartimin dhe menaxhimin e të gjitha procedurave për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve në vendin e punës duke përfshirë dokumentin e vlerësimit të rrezikut të kërkuar nga Dekreti Legjislativ 626/94, duke përfshirë kontrollet e temperaturës dhe lagështisë për mjediset civile dhe industriale, hetimet mikroklimatike në mjediset e punës, përpunimin e dokumenteve, vlerësimin e rrezikut nga zjarri dhe planin e emergjencës dhe evakuimit, përpunimin e dokumenteve të rrezikut të shkarkimeve atmosferike, përpunimin e dokumenteve të rrezikut të shpërthimit, koordinimin e hartimit të planit dhe sigurinë në kantieret e ndërtimit, hartimin e planit të sigurisë operative, koordinimin për projektimin dhe ekzekutimin e shesheve të ndërtimit, zbulimin instrumental të zhurmës për vlerësimin e ekspozimit të punëtorëve, si dhe monitorimin e ndikimit mjedisor në ambiente civile dhe industriale, përfshirë këtu ato të jashtme dhe për banim, llogaritjen e rrezikut kimik, dokumentacionin, vlerësimet inxhinierike të ndriçimit, analizat e vendeve të punës në терминаlet video, projektimin dhe riparimin e mjediseve të punës, analizat e pluhurit, mbikëqyrjen shëndetësore, ekzaminime mjekësore dhe çdo shërbim dhe/ose aktivitet tjetër përkatës, të supozuar dhe në çdo rast të nevojshëm për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- Konsulencën, menaxhimin, koordinimin, tutorimin, mësimdhënien, asistencën dhe/ose organizimin, si dhe çdo lloj aktiviteti të ndërlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm, përfshirë edhe lidhjen e kontratave dhe/ose nënkontratave, të kurseve të trajnimit të përgjithshëm që synojnë sektorin publik dhe privat, kurse të cilat janë teorike dhe praktike, me në qendër përgjithësisht sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës, duke përfshirë edhe kurse trajnimi për drejtuesin e shërbimit të parandalimit dhe mbrojtjes në punë, trajnime për punonjësit e ndihmës së parë, trajnime për zjarrfikësit dhe menaxhimin e emergjencave me rrezik të ulët dhe të mesëm, trajnime dhe informacion për punëtorët, trajnime për punëtorët që i nënshtrohen rrezikut të shpërthimit, sistemet e certifikimit të kompanisë, cilësisë mjedisore dhe HACCP, shitjet dhe marketingun, përzgjedhjen, menaxhimin, administrimin, kualifikimin dhe rritjen profesionale të burimeve njerëzore dhe menaxhimin e strukturave të shitjes.

- Të drejtën për të mundur realizimin e objektit të korporatës nëpërmjet tipave të reklamimit të çdo forme dhe lloji duke përfshirë mbajtjen e kongreseve, seminareve, programeve master dhe të ngjashme, si dhe të çdo nisme tjetër të përshtatshme për arritjen dhe promovimin e objektit të korporatës.

- Projektet e trajnimit dhe/ose shërbimet e asistencës, si dhe çdo lloj aktiviteti të ndërlidhur, të supozuar dhe në çdo rast i qenësishëm, edhe në emër të personave të tjerë juridikë, për përfitimin e donacioneve publike dhe/ose private në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.

- Impiantet për prodhimin, transportin dhe përdorimin e energjisë, përfshirë këtu energjinë elektrike, duke përfshirë shpërndarjen dhe shitjen, duke përfshirë trajtimin, përdorimin, akumulimin dhe konsumin e ujit dhe ajrit brenda ndërtesave, duke përfshirë montimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin përkatës të sistemet përkatëse si dhe çdo lloj aktiviteti të lidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishëm.

- Botimin dhe shitjen (në të gjitha format e vlefshme ligjore, brenda dhe jashtë selisë së saj) të botimeve në përgjithësi - libra, revista, kancelari dhe artikuj të ngjashëm - si dhe të çdo produkti botues, duke përfshirë gazetatat dhe revistat periodike, menaxhimin e librarive dhe agjencive të librave më vete dhe për llogari të palëve të treta si dhe çdo lloj veprimtarie të lidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishme.

- Çdo lloj veprimtarie që lidhet me përdorimin e e-commerce në internet, faqet e internetit, hostimin dhe teknologjinë e informacionit duke përfshirë programimin, zbatimin, menaxhimin, mirëmbajtjen si dhe çdo lloj aktiviteti të bashkëlidhur, të supozuar dhe në çdo rast të qenësishme.

- Objekti i korporatës përfshin gjithashtu blerjen, shitjen dhe tregtimin me çfarëdolloj të drejte (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) të pasurive të paluajtshme dhe tërësisë së pasurive të luajtshme; marketimin në çdo formë të të gjitha produkteve në sektorin joushqimor.

Veç kësaj, shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, prodhuese, bankare, industriale dhe financiare, kreditore, në letra me vlerë dhe pasuri të paluajtshme, të cilat organi administrativ i konsideron të nevojshme ose të nevojshme për arritjen e qëllimit të korporatës ose në çdo rast të bashkëlidhura me të, duke përfshirë blerjen të aksioneve ose të pjesëve në shoqëri të tjera me qëllim të ngjashëm ose të njëjtë.

Shoqëria mund të japë gjithashtu fidejuzione dhe garanci reale në favor të të tretëve, subjekteve, personave fizikë e juridikë dhe bankave si dhe në favor të vetë aksionarëve.

PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË - KUOTAT

NENI 6) Kapitali i shoqërisë është 10000 (dhjetë mijë) Euro i ndarë në aksione me vlerë nominale nga një euro secila.

Në rast të rritjes së kapitalit aksionar, e drejta e opsionit të blerjes u rezervohet ortakëve.

Shoqëria mund të marrë, edhe nëse nuk miratohet nga asambleja, paradhënie nga ortakët për rritje të ardhshme të kapitalit aksionar në një mënyrë rreptësisht proporcionale me kapitalin aksionar të nënshkruar nga secili prej tyre; asnjë interes nuk mund të kërkohet për këto kredi.

Shoqëria nuk është e detyruar të zbatojë rritjen e kapitalit aksionar brenda një periudhe të caktuar dhe do të mund të kthejë paradhëniet e marra, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve dhe nevojave të likuiditetit të saj.

Ortakët mund t'i japin shoqërisë edhe hua pa interes dhe me interes me kërkesë të organit administrativ, si dhe në mënyrë jo proporcionale me kapitalin aksionar të nënshkruar.

Shoqëria mund të marrë gjithashtu fonde me detyrim shlyerje nga ortakët, pa kryer një grumbullim kursimesh nga publiku, në përputhje me kufijtë dhe kriteret e përcaktuara nga Komiteti Ndërmintor për Kreditë dhe Kursimet me rezolutën e datës 3 mars 1994 (dhe çdo ndryshim tjetër të mëvonshëm), në zbatim të dispozitave të nenit 11 të Dekretit Legjislativ nr. 385, më 1 shtator 1993 (Ligji i Konsoliduar për bankat dhe kredinë).

NENI 7) Aksionet janë të transferueshme si përmes transaksioneve inter vivos ashtu edhe përmes atyre mortis causa dhe e drejta e parablerjes u rezervohet ortakëve në të njëjtat kushte.

Kjo e drejtë nuk funksionon në rast të transferimit të aksioneve ortakëve të tjerë ose shoqërive në të cilat kanë pjesë të njëjtët ortakë.

Në rast vdekjeje të një ortaku, ortakët që janë gjallë kanë të drejtë t'ia blejnë trashëgimtarëve pjesën e të ndjerit.

Ortaku që vendos të shesë aksionet e tij ose një pjesë të tyre përmes transaksioneve inter vivos duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë për këtë vendim të tij përmes një letre rekomande me vërtetim marrjeje të dërguar në adresën e treguar në regjistrin e ortakëve, duke i njoftuar ata për çmimin e kërkuar ose vlerën e aksioneve.

Brenda afatit prej tridhjetë ditësh nga ky njoftim, ortakët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në përpjesëtim me aksionet e zotëruara dhe sërish me letër rekomande me vërtetim marrjeje t'ia njoftojnë vendimin e tyre ortakut që po shet aksionet.

Nëse njëri prej ortakëve vendos të mos e ushtrojë të drejtën e parablerjes, kjo e drejtë mund të ushtrohet proporcionalisht nga ortakët e tjerë.

Në mungesë të një marrëveshjeje, vlera e aksioneve do të përcaktohet nga Arbitri që do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës brenda juridiksionit të së cilës gjendet selia e shoqërisë.

Shitësi i aksioneve ka të drejtë të heqë dorë nga transferimi i kërkuar, duke iu shmangur ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nëse vlerëson se çmimi i vendosur nga arbitri është i pamjaftueshëm.

Në rast të mosrespektimit të rregullave të përcaktuara nga ky nen, shitja do të jetë e pavlefshme në raport me Shoqërinë.

Procedura e parashikuar në këtë nen nuk zbatohet në rastin e kalimit të aksioneve tek bashkëshorti, fëmijët dhe pasardhësit e drejtpërdrejtë të ortakut shitës, meqenëse nuk ka asnjë kufizim për këtë transaksion.

PJESA III
ASAMBLETË



NENI 9) Asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ortakëve do të thirren nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Këshillit të Administrimit me letër rekomande me vërtetim marrjeje, e cila iu dërgohet ortakëve në adresën e treguar në regjistrin e ortakëve ose me çdo mjet tjetër të përshtatshëm për këtë qëllim (faks, e-mail ose mjet të ngjashëm), të paktën tetë ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Letra duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e takimit dhe listën e çështjeve që do të diskutohen.

E njëjta letër do të tregojë vendin, datën dhe orën e sesionit të dytë të asamblesë, nëse i pari nuk arrin pjesëmarrjen e kërkuar nga Statuti.

Do të jenë sidoqoftë të vlefshme asambletë e ortakëve, edhe nëse nuk thirren si më sipër, nëse në to përfaqësohet i gjithë kapitali aksionar dhe marrin pjesë të gjithë administratorët dhe revizorët, nëse janë emëruar, ose informohen dhe askush nuk kundërshton; megjithatë, në këtë rast, secili nga të pranishmit mund të kundërshtojë trajtimin e çështjeve për të cilat nuk e konsiderojnë veten të informuar.

NENI 10) Asambleja do të thirret sa herë që vlerësohet e përshtatshme nga Administratori i Vetëm ose Kryetari i Këshillit të Administrimit; sidoqoftë, të paktën një herë në vit duhet të mbledhet në sesion të zakonshëm brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga përfundimi i vitit financiar ose brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kur lind një nevojë e veçantë, për miratimin e pasqyrave financiare dhe të akteve të tjera të shoqërisë, dhe duhet të mbledhet sapo të jetë e mundur, brenda pesëmbëdhjetë ditëve, nëse kjo gjë kërkohet nga një numër ortakësh që zotërojnë të paktën një të pestën e kapitalit aksionar.

NENI 11) Si President i Asamblesë caktohet Administratori i Vetëm apo Kryetari i Këshillit të Administrimit; në rast se këta mungojnë, caktohet Zëvendëskryetari i Këshillit të Administrimit, ndërsa në rast se të gjithë këta mungojnë apo kanë ndonjë pengesë çfarëdo, për këtë qëllim caktohet një ortak i zgjedhur nga pjesëmarrësit e pranishëm.

NENI 12) Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet në të edhe prej një personi që nuk është ortak duke paraqitur një prokurë me shkrim, me kusht që ky i fundit të mos jetë administrator, revizor, apo i punësuar i shoqërisë.

NENI 13) Vendimet e asamblesë do të paraqiten në procesverbalin e hartuar në të njëjtën kohë në regjistrin e shoqërisë nën përgjegjësinë e Presidentit dhe nga një sekretar, i caktuar nga Presidenti me miratimin e asamblesë edhe ndër ata nuk janë ortakë, me kusht që të dyja palët ta kenë miratuar atë, përveç rasteve kur procesverbali me kërkesë të Presidentit apo të Asamblesë apo në përputhje me ligjin duhet të hartohet nga një Noter.

NENI 14) Vendimet e asambleve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme merren në sesionin e parë me votën e favorshme të atyre ortakëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë.

Në sesionin e dytë, vendimet e asambleve qofshin këto të zakonshme apo të jashtëzakonshme merren me shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë të pranishëm ose të përfaqësuar, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

NENI 15) Vendimet e ortakëve mund të merren edhe me metodën e konsultimit me shkrim ose të miratimit të shprehur me shkrim, me përjashtim të rasteve kur në përputhje me ligjin apo me statutin në fjalë është i detyrueshëm përdorimi i metodës së votimit në asamble.

PJESA IV

ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

NENI 16) Shoqëria drejtohet nga një Administrator i vetëm ose nga një Këshill Administrimi i përbërë nga një numër i ndryshueshëm anëtarësh, minimumi dy dhe maksimumi shtatë, siç përcaktohet në vendimet e herëpashershme të asamblesë, organ i cili do të jetë përgjegjës në një rast të dytë edhe për emërimin e Kryetarit.

Organi administrativ zgjidhet për herë të parë në aktin e themelimit.

Administratori i vetëm ose Këshilli i Administrimit mund të rizgjidhen dhe qëndrojnë në detyrë për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar të vendosur në çastin e emërimit, ose derisa të revokohen nga asambleja, ose për shkak të dorëheqjes, mbarimit të mandatit a vdekjes.

Administratorët mund të mos jenë ortakë të shoqërisë.

NENI 17) Organi administrativ zotëron kompetencat më të gjera të mundshme për administrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që i çmon të përshtatshme për zbatimin dhe arritjen e objektit të shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji i parashikon rreptësisht për asamblenë.

NENI 18) Organit administrativ i takon përfaqësimi ligjor i shoqërisë përpara të palëve të treta dhe në gjykatë, me të drejtën e kryerjes së veprimeve dhe të paraqitjes së akteve gjyqësore dhe administrative.

Administratori i vetëm ose Kryetari i Këshillit të Administrimit të cilët gëzojnë të drejtën për të nënshkruar në emër të shoqërisë, mund të emërojnë një ose më shumë përfaqësues ligjorë, duke përcaktuar kompetencat e tyre.

Këshilli i Administrimit mund t'i delegojë Kryetarit ose Zëvendëskryetarit, apo një ose më shumë Anëtarëve të Këshillit, të gjitha kompetencat që mund të delegohen sipas ligjin, por mund t'ia delegojnë detyrat e shoqërisë edhe palëve të treta, qofshin këta ortakë apo jo.

NENI 19) Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për shkak të detyrës së tyre.

Asambleja mund të caktojë gjithashtu një kompensim vjetor për administratorët. Ortakët gjithashtu mund të vendosin një kuotë vjetore që do të ndahet si kompensim për ndërprerjen e mandatit të administratorëve në përputhje me dispozitat e Ligjit të Konsoliduar për Tatimet mbi të ardhurat, Neni 105, Paragrafi IV (Dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 917, më 22/12/1986) edhe nëpërmjet përcaktimit të policave të sigurimit që trajtojnë përfundimin e mandatit.

NENI 20) Këshilli i Administrimit, nëse emërohet, mblidhet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe gjetkë, sa herë që Kryetari i tij e gjykon të nevojshme ose edhe kur kërkohet qoftë nga një anëtar i vetëm.

NENI 21) Thirrja e mbledhjes e Këshillit të Administrimit mund të bëhet nga Kryetari i tij pesë ditë përpara datës së caktuar, edhe me telegram të dërguar të paktën dy ditë para mbledhjes në banesën e çdo anëtari të tij.

NENI 22) Vendimet e Këshillit të Administrimit mund të merren edhe me metodën e konsultimit me shkrim ose me miratimin e shprehur me shkrim, me përjashtim të rasteve kur në përputhje me ligjin ose me këtë statut, përdorimi i metodës së asamblesë është i detyrueshëm.

NENI 23) Lipset prania e shumicës së anëtarëve në detyrë që vendimet e Këshillit të Administrimit të jenë të vlefshme.

Vendimet merren me shumicë absolute të votave të të pranishmëve. Nëse Këshilli i Administrimit përbëhet nga më shumë se dy anëtarë, vota e Kryetarit mbizotëron në rast barazie votash.

NENI 24) Regjistri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Këshillit të Administrimit mbahet nga Kryetari i këtij Këshilli.

PJESA V
KOLEGJI SINDAKAL DHE REVIZORI

NENI 25) Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet Kolegjit Sindakal ose një Revizori. Kolegji Sindakal, kur kërkohet nga asambleja ose me ligj, do të përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy zëvendësues, që të gjithë të emëruar nga asambleja, nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryetari i Kolegjit Sindakal. Anëtarët e Këshillit ose Revizori qëndrojnë në detyrë për tre vjet. Asambleja përcakton edhe shpërblimin që i takon anëtarëve të Këshillit Sindakal ose revizorit.

PJESA VI
PËRJASHTIMI

NENI 26) Në rastin e një ortakut, i cili për shkak të një detyrimi kontribues detyrohet të ofrojë punë ose shërbime në favor të shoqërisë, ky i fundit mund të përjashtohet prej detyrimit në fjalë nëse nuk është më në gjendje që të ofrojë punën ose shërbimet që parashikon detyrimi. Mund të përjashtohet gjithashtu një ortak që është përjashtuar, ka shpallur falimentimin ose që është dënuar me një vendim të formës së prerë që parashikon si dënim ndalimin e të drejtës për të ushtruar funksione publike.

PJESA VII
BILANCI DHE ASETET

NENI 27) Viti financiar përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar do të mbyllet më 31 dhjetor 2005. Në fund të çdo viti financiar, organi administrativ do të procedojë me përgatitjen e bilancit të shoqërisë që do të hartohet në përputhje me ligjin.

NENI 28) Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare të miratuara nga asambleja do të ndahen si më poshtë:

- 5% (pesë për qind) në rezervën e zakonshme derisa të arrihet një e pesta e kapitalit të shoqërisë;
- pjesa e mbetur në dispozicion të ortakëve, përveç rastit kur asambleja vendos të ndajë të gjithë atë ose një pjesë të saj për provizione në favor të rezervave të veçanta.

PJESA VIII
SHËRNDARJA DHE LIKUIDIMI

NENI 29) Kur merr vendimin për shpërndarjen e shoqërisë në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, mbledhja e jashtëzakonshme e ortakëve do të përcaktojë edhe procedurat e likuidimit dhe do të emërojë një ose më shumë likuidues, duke vendosur kompetencat dhe kompensimin e tyre.

PJESA IX
TITUJT E BORXHIT

NENI 30) Shoqëria mund të emetojë tituj borxhi në mënyrat dhe brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

Emetimi miratohet nga asambleja e ortakëve me atë shumicë votash që parashikohet për ndryshimin e këtij statuti.

PJESA X
MOSMARRËVESHJET

NENI 31) Zgjidhja e çdo mosmarrëveshjeje sa i përket të drejtave të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e shoqërisë do t'i paraqitet një paneli arbitrazhi të përbërë nga tre arbitra, të cilët do të emërohen nga një palë e tretë jashtë shoqërisë, dhe në marrëveshje të ndërsjellë mes palëve ose, në mungesë të një marrëveshjeje, nga Kryetari i Gjykatës së Peruxhias.

Kolegji i Arbitrazhit do të vendosë për çështjet e mosmarrëveshjeve sipas ligjit.

NENI 32) Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut dhe në aktin e themelimit palët do t'i drejtohen Kodit Civil dhe ligjeve të veçanta në fuqi që rregullojnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.

MODELI I PËRBASHKËT INFORMATIK - AKT I LËSHUAR NË PROCESIN E REGJISTRIMIT PËR PËRDORIM TË REGJISTRIT TË NDËRMARRJEVE. KOPJE E LËSHUAR ME MBËSHTETJE INFORMATIKE NË PËRPTHJE ME DOKUMENTIN FILLESTAR NË LETËR, NË PËRPTHJE ME NENIN 20 TË DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 445/2000.

TAKSA POSTALE ËSHTË SHLYER NË PËRPTHJE ME DEKRETIN 22/02/2007 PËRMES MODELIT TË PËRBASHKËT INFORMATIK.

Per theu!
Sirius Tortori
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO



V2022050250209197647

DATE 06/05/2022
NR REP 2476

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 06/05/2022, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

PËRKTHYESI:

Sirius Tartari, atësia Arben, amësia Jutbina, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë Rajoni 2 L"isa Boletini"; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Vlorë; Vlorë; 0000; Vlorë, lindur më 20/08/1994, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 031208674 dhe nr. personal J45820110W.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Statut dhe Akt themelimi te Sekuritalia Srl", nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
LORIANA A. ROBO

